

Përmbajtja e lëndës

Vendim nr. 214,
datë 11.3.2015

Për përcaktimin e afateve dhe masave që duhet të merren në lidhje me ankesat për gabimet dhe defektet e botimit dhe publikimit

Udhëzim nr. 8451/4,
datë 5.1.2015
{I ndryshuar}

Për caktimin e çmimit dhe tarifave të botimeve të Qendrës së Botimeve Zyrtare, si dhe institucionet që përfitojnë falas kopje të botuara të Fletores Zyrtare.

Udhëzim nr. 2,
datë 11.03.2015

Për mënyrën, format dhe procedurën e dërgimit të tekstit të akteve të botueshme në fletoren zyrtare, si dhe formatin e shkruar në letër dhe formatin elektronik të tyre.

Udhëzim nr.3,
datë 11.3.2015

Për formatin, kriteret teknike, procedurat e përgatitjes, ditët e botimit, tirazhin e kopjeve, mënyrën e vënies në qarkullim dhe shpërndarjen e Buletinit të Njoftimeve Zyrtare.

Vkm nr. 279,
datë 12.02.2015

Për përcaktimin e tirazhit të Fletores Zyrtare në formë të shtypur.

VENDIM
Nr. 214, datë 11.3.2015

**PËR PËRCAKTIMIN E AFATEVE DHE MASAVE QË DUHET TË MERREN NË
LIDHJE ME ANKESAT PËR GABIMET DHE DEFEKTET E BOTIMIT DHE
PUBLIKIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 17, të ligjit nr. 78/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Qendra e Botimeve Zyrtare pranon ankesat lidhur me gabimet dhe defektet që kanë të bëjnë me botimin dhe publikimin e akteve të botueshme në Fletoren Zyrtare, si dhe të njoftimeve në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, në formë të shtypur ose në formëelektronike.

2. Institucioni që ka nxjerrë aktin ose çdo person i interesuar që identifikon një defekt apo gabim si mospërputhje me origjinalin bën ankesë me shkrim për ndreqjen e tij pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

3. Qendra e Botimeve Zyrtare, në bashkëpunim me institucionin që ka nxjerrë aktin, verifikon ekzistencën e defektit apo gabimit dhe bën ndreqjen, përkatësisht, në Fletoren Zyrtare apo në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare më të parë.

4. Afatet e trajtimit të këtyre ankesave janë brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga data e marrjes së ankesës. Qendra e Botimeve Zyrtare, brenda këtij afati, i dërgon përgjigje institucionit apo personit që ka bërë ankesën, duke dhënë informacion edhe për masat e marra.

5. Në rast se gabimi apo defekti identifikohet nga vetë Qendra e Botimeve Zyrtare, ndreqja e gabimit apo defektit bëhet në Fletoren Zyrtare apo në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare më të parë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 8451/4, datë 5.1.2015

**PËR CAKTIMIN E ÇMIMIT DHE TARIFAVE TË BOTIMEVE TË QENDRËS SË
BOTIMEVE ZYRTARE, SI DHE INSTITUCIONET QË PËRFITOJNË FALAS KOPJE TË
BOTUARA TË FLETORES ZYRTARE**
(ndryshuar me udhëzimin nr.21, datë 14.10.2020)

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe të nenit 16, pika 4, të ligjit nr.78/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare”, ministri i Drejtësisë dhe ministri i Financave

UDHËZOJNË:

1. Çmimi i shitjes së çdo botimi, përfshirë dhe Fletoren Zyrtare, llogaritet si prodhim i çmimit për një faqe me numrin e faqeve të botimit. Çmimi për faqe është 4 (katër) lekë.

2. Për botimet me lidhje speciale, çmimi total i botimit është i barabartë me çmimin e prodhimit (4 lekë për numër faqesh) plus 250 lekë.

3. Çdo subjekt i interesuar mund të bëjë abonim vjetor pranë “Posta Shqiptare” sh.a.

4. Botimet, përfshirë edhe Fletoren Zyrtare, mund të shiten drejtpërdrejt nga Qendra e Botimeve Zyrtare me çmimin e vendosur në kapak. Pagesa kryhet në llogaritë e thesarit në sistemin bankar për llogari të Qendrës së Botimeve Zyrtare.

5. Çmimi i abonimit vjetor pranë “Posta Shqiptare” sh.a., për Fletoren Zyrtare, është 20 000 (njëzet mijë) lekë.

6. Çmimi i shitjes së botimeve për libraritë dhe agjencitë shpërndarëse llogaritet me një zbritje prej 5% mbi çmimin e llogaritur sipas pikës 1, të këtij urdhri (kur ky aktivitet pasqyrohet në objektin e aktivitetit tregtar të këtij subjekti tregtar).

7. Çmimi i shitjes së serive të Fletoreve Zyrtare në CD-ROM për secilin vit, është 5000 (pesë mijë) lekë.

8. Konsultimi i akteve të botuara në Fletoren Zyrtare në faqen zyrtare të internetit është falas.

9. Për konfirmimet dhe kopjet e akteve të caktuara, do të zbatohet çmimi 20 (njëzet) lekë për fletë.

10. Për shumëfishime të Fletores Zyrtare të numrave të kaluar, jashtë tirazhit të përcaktuar, do të zbatohet çmimi 20 (njëzet) lekë për faqe.

11. Shpërndarja e Fletores Zyrtare, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë realizohet me kontratë me "Posta Shqiptare" sh.a., e cila mban 10% të vlerës së abonimit.

12. Institucionet që përfitojnë falas kopje të botuara të Fletores Zyrtare, janë ato të përcaktuara sipas ligjeve të posaçme.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Nasip Naço

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani

UDHËZIM
Nr. 2, datë 11.03.2015

PËR MËNYRËN, FORMAT DHE PROCEDURËN E DËRGIMIT TË TEKSTIT TË AKTEVE TË BOTUESHME NË FLETORËN ZYRTARË, SI DHE FORMATIN E SHKRUAR NË LETËR DHE FORMATIN ELEKTRONIK TË TYRE

Në mbështetje të pikës 5, të nenit 100, të Kushtetutës dhe të pikës 12, të nenit 8, të ligjit nr. 78/2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

1. Teksti i akteve të botueshme në Fletoren Zyrtare i dërgohet Qendrës së Botimeve Zyrtare, në formatin e shkruar në letër dhe në formatin elektronik, nga institucionet shtetërore përkatëse, që kanë miratuar aktin në të njëjtën ditë, por, në çdo rast, jo më vonë se afatet e parashikuara në nenin 8, ligjit nr. 78/2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare".
2. Aktet e botueshme publikohen në Fletoren Zyrtare vetëm atëherë kur versioni përfundimtar, në origjinal, i aktit, është nënshkruar nga organi që e ka nxjerrë atë dhe me kërkesën e tij.
3. Akti i dërguar në formë elektronike duhet të jetë në formatin Word dhe duhet të dërgohet përmes postës elektronike zyrtare ose në CD, bashkëlidhur aktit në formë shkresore.
4. Materiali duhet të dërgohet pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare sipas standardit të gjuhës shqipe. Këto standarde duhen zbatuar edhe për dokumentet bashkëlidhur aktit.
5. Institucioni shtetëror, që dërgon aktin e botueshëm, nëse është e mundur, kujdeset që formati elektronik të nënshkruhet elektronikisht, sipas legjislacionit në fuqi.
6. Të dyja formatet kanë vlerë të njëjtë juridike. Në rast mospërputhjeje të formateve, Qendra e Botimeve Zyrtare i kërkon institucionit të konfirmojë përmbajtjen e saktë të aktit të botueshëm dhe, vetëm pas përgjigjes zyrtare të institucionit dërgues, vijon me botimin e aktit.
7. Marrëveshjet ndërkombëtare botohen, krahas gjuhës shqipe, edhe në gjuhën angleze, në rast se janë nënshkruar në këtë gjuhë. Botimi bëhet në të njëjtën faqe, të ndarë në dy kolona, ku secilit nen në gjuhën shqipe i korrespondon neni në gjuhën angleze dhe, në pjesën e fundit të tyre, vendoset data e nënshkrimit të tyre.

8. Ngarkohen Qendra e Botimeve Zyrtare dhe të gjitha institucionet shtetërore, që botojnë akte në Fletoren Zyrtare, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

UDHËZIM
Nr.3, datë 11.3.2015

PËR FORMATIN, KRITERET TEKNIKE, PROCEDURAT E PËRGATITJES, DITËT E BOTIMIT, TIRAZHIN E KOPJEVE, MËNYRËN E VËNIES NË QARKULLIM DHE SHPËRNDARJEN E BULETINIT TË NJOFTIMEVE ZYRTARE

Në mbështetje të pikës 5, të nenit 100, të Kushtetutës, dhe të pikës 5, të nenit 5, të ligjit nr.78/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

1. Buletini i Njoftimeve Zyrtare botohet në formatin A4, bardhezi, letër 80 gr/m², mat, pa lustër, sipas formatit të përcaktuar në shtojcën nr.1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 2. Lidhja bëhet me qepje me tel, për një numër faqesh deri në 80, dhe me ngjitje, për numër faqesh më shumë se 80.
 3. Procedura e përgatitjes dhe botimit të Buletinit të Njoftimeve Zyrtare është e njëjtë me atë të përgatitjes dhe botimit të Fletores Zyrtare.
 4. Buletini i Njoftimeve Zyrtare botohet çdo të hënë. Në rastet kur është e nevojshme, për shkak të numrit të madh të njoftimeve të institucioneve shtetërore, buletini mund të botohet edhe në ditët e tjera të punës.
 5. Teksti i njoftimeve i dërgohet Qendrës së Botimeve Zyrtare, njëkohësisht, në formatin e shkruar në letër dhe në formatin elektronik, nga institucionet shtetërore përkatëse, që kanë miratuar aktin.
 6. Njoftimet botohen në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare vetëm atëherë kur versioni përfundimtar, në origjinal, i aktit, është nënshkruar nga organi që e ka miratuar atë dhe me kërkesën e tij.
 7. Botimi bëhet brenda 10 ditëve pune nga momenti i paraqitjes, njëkohësisht, së të dyja formateve të kërkuara, formati i shkruar në letër dhe formati elektronik.
 8. Materiali i dërguar në formatin elektronik duhet të jetë në formatin Word dhe duhet të dërgohet me postën elektronike zyrtare ose në CD.
 9. Materiali duhet të dërgohet pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare sipas standardit të gjuhës shqipe.
 10. Në rast mospërputhjeje të të dyja formateve, Qendra e Botimeve Zyrtare i kërkon institucionit të konfirmojë përmbajtjen e saktë të aktit të botueshëm dhe, vetëm pas përgjigjes zyrtare të institucionit dërgues, vijon me botimin e aktit.
 11. Tirazhi i Buletinit të Njoftimeve Zyrtare është 500 copë.
 12. Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në sportelet e Postës Shqiptare.
 13. Ngarkohet Qendra e Botimeve Zyrtare dhe institucionet shtetërore për zbatimin e këtij udhëzimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.legjislacioni.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri:
1

Tiranë – E , tetor 2014

PËRMBAJTJA

Faqe

Njoftim i Ministrisë së Drejtësisë		
Njoftim i Ministrisë së Financave		
Njoftim i Ministrisë së Punëve të Jashtme		
Njoftim Ministria e Mbrojtjes		
Njoftim Ministria e Arsimit dhe Sportit		
Njoftim Ministria e Shëndetësisë		
Njoftim Ministria e Kulturës		
Njoftim Ministria e Energjisë dhe Industrisë		
Njoftim i Ministrisë së Mireqenies Sociale dhe Rinisë		
Njoftim i Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave		

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

URDHËR
Nr. 279, Datë 12.02.2015

**PËR PËRCAKTIMIN E TIRAZHIT TË FLETORES ZYRTARE NË FORMË TË
SHTYPUR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar dhe të nenit 6, pika 3, të ligjit nr. 78/2014, datë 10.7.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare",

URDHEROJ:

1. Tirazhi i Fletores Zyrtare, për një vit kalendarik, do të jetë sa numri i abonimeve të bera pranë Postës Shqiptare, duke shtuar 50 kopje për shitje të lire.
 2. Fushata e abonimit për vitin e ardhshëm kalendarik fillon në 1 shtator dhe mbyllet në 24 dhjetor të çdo viti.
 3. Ngarkohet Qendra e Botimeve Zyrtare për zbatimin e këtij Urdhri.
 4. Ngarkohet Sektori i Redaktimit Gjuhësor dhe Arkiv-Protokollit për njoftimin e këtij urdhri.
- Ky urdher hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
NASIP NAÇO